

VENDIM

Lënda: Renditja e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh në programin e studimit M.SH në Arkitekturë-profilin Arkitekt për vitin akademik 2017-2018.

Komisioni ad hoc i ngritur me vendim të Dekanit, Nr.36 datë 25.09.2017, për vlerësimin e kandidatëve që aplikojnë për transferim studimesh dhe program të dytë studimi, pasi mori në shqyrtim kërkesat dhe dokumentacionin e paraqitur nga 8 (tetë) kandidatë vendosi:

Mbështetur në Udhëzimin Nr.18 datë 16.08.2017 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Për procedurat e pranimit dhe regjistrimit të kandidatëve që aplikojnë për transferim të studimeve dhe për program të dytë studimi, në programet e ciklit të dytë të studimeve në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018, Vendimin e Rektoratit Nr.60 datë 08.09.2017 për “Kriteret e pranimit të kandidatëve që transferojnë studimet në programe të njëjta apo programe të ngjashme studimi në UPT për vitin akademik 2017-2018” si dhe në Rregulloren e UPT, të skualifikojë nga procesi i renditjes së kandidatëve dy aplikues;

- 1- *Isla Klement Meçe* – për mungesë të programeve të lëndëve të zhvilluara në programin e studimit nga i cili vjen.
- 2- *Engjëll Xhevahir Jolla* – për mos plotësim të pragut të 30 ECTS të fituara në programin e studimit që ka kryer

Bazuar në sa mësipër dhe në kriteret specifike të hartuara, komisioni ad hoc shpalli renditjen sipas listës bashkangjitur.

Komisioni Ad Hoc

1. Dr. Etleva BUSHATI
2. Prof. Asoc. Armand VOKSHI
3. Dr. Denada VEIZAJ
4. Dr. Endrit TUZI
5. Daniel QAMO
6. Irina BRANKO